



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 144, datë 28.08.2024

PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË “RSM ALBANIA” SH.P.K.,
SI SHOQËRI AUDITUESE PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË
SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIK TË
“CREDINS INVEST” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe të rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të SHAFP dhe SIK”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë “RSM Albania” sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë audituese, për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të shoqërisë administruese “Credins Invest” sh.a., fondit të pensionit “Credins Pension”, fondit të investimit “Credins Premium”, fondeve të investimit alternativ “Sea Land Alternative Investment Fund” dhe “Green View Alternative Investment Fund”, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2024.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI